



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**V E N D I M**

**PËR NXJERRJEN E REZULTATIT TË VOTIMIT PËR ZGJEDHJEN E KËSHILLIT TË BASHKISË  
KAMËZ, QARKU TIRANË, NË ZGJEDHJET VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 06.07.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me

**OBJEKT:** Për nxjerrjen e rezultatit të votimit për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Kamëz, Qarku Tiranë, në zgjedhjet vendore të datës 30 Qershor 2019.

**BAZË LIGJORE:** Neni 21, pika 7, neni 23, pika 1, germa "a", neni 123 të ligjit Nr.10019 datë 29.12.2009 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

**VËREN**

Zona Zgjedhore Bashkia Kamëz territori i saj është i ndarë në 2 ZAZ. Në këtë rast KQZ-ja verifikon dhe nxjerr rezultatit për zonën zgjedhore, në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore përkatëse.

Në përfundim të procesit të dorëzimit të Tabelave Përmbledhëse të Rezultateve dhe Tabelave të Rezultateve për çdo qendër votimi për Këshillin e Bashkisë Kamëz nga të 2 KZAZ-të e kësaj bashkie, KQZ, nxjerr rezultatit për këtë zonë zgjedhore, duke ndjekur procedurat e parashikuara në nenin 123 të Kodit.



Përpara plotësimin të Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Kamëz, u krahasuan Tabelat e Rezultatit për kandidatët për këshill të qendrave të votimit të këtyre KZAZ-ve, të plotësuara nga Grupet e Numërimit me Tabelat Përmbledhëse të Rezultatit të miratuara nga KZAZ nr.27, KZAZ nr.28, dhe rezultatit të tyre të hedhur në sistemin elektronik, rezultoi se:

- Tabelat Përmbledhëse të Rezultateve të miratuara nga KZAZ nr.27, KZAZ nr.28, përfshijnë rezultatin e të gjitha tabelave të rezultateve të QV-ve që kanë këto ZAZ.

- Nga krahasimi i tabelave të rezultatit për çdo qendër votimi me tabelat përmbledhëse të rezultatit të ZAZ-së përkatëse dhe rezultatit të tyre të hedhur në sistemin elektronik, u vërejtën mospërputhjet e shifrave si më poshtë:

#### **Bashkia Kamëz Këshill**

<b>Nr.</b>	<b>QV me probleme</b>		<b>GN</b>	<b>TPR</b>	<b>SISTEM I</b>
1	15691	Fletë votimi të papërdorura	694	694	0
2	15711	Fletë votimi të papërdorura	608	608	0
3	15751	Fletë votimi të papërdorura	891	891	0
4	15751	Fletë votimi të dëmtuara	0	0	125

KQZ do të miratojë me vendim Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Kamëz, Qarku Tiranë, me shifrat e korrigjuara, mbështetur në origjinalet e tabelave të rezultateve të çdo qendre votimi të kësaj Bashkie, të plotësuar nga grupi i numërimit të votave.

#### **PËR KËTO ARSYE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 21, pika 7, neni 23, pika 1, germa "a" dhe nenin 123, të ligjit Nr.10019 datë 29.12.2009 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

#### **V E N D O S I:**

1. Të miratojë Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Kamëz, Qarku Tiranë, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykates së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

**Klement ZGURI - Kryetar**

**Denar BIBA - Zv.Kryetar**

**Bledar SKËNDERI- Anëtar**

**Edlira JORGAQI- Anëtare**

**Rezarta BITRI- Anëtare**

